**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**Vula e Autoritetit Kontraktor**

**Shtojca 10**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE**

Operatori ekonomik: \_\_\_\_\_

**Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt:** \_\_\_\_\_

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					



**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

**PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)**

**Emri:**

**Adresa:**

**Nr. Telefonit:**

**Faks:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

### Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

### DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS<sup>4</sup>

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

<sup>4</sup> Kjo deklaratë ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatorit ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

### **Shtojca 12**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

#### **2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Referoju pikes 1 te kriterete te pergjithshme shtojca 12

#### **2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

- a) Kopje te vertetuar te bilanceve, te konfirmuara me vule prane autoriteteve perkate se (Administrates Tatimore ) te tre viteve te fundit te aktivitetit (2017, 2018, 2019). Te gjitha subjektet qe i nenshtrohen përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar,
- b) Vertetim të xhiros vjetore per tre vitet e fundit (2017, 2018,2019), ku xhiroja mesatare e tre viteve të mos jete më pak se 50% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.
- c) Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.
- d) Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) I ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, per vitin 2019 dhe 2020, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë kete dokument).

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

### **2.3 Per kapacitetin teknik:**

#### **Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:**

1) Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën :

- a.* Punë të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri vitet të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.  
**ose**
- b.* Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është **në një vlerë jo më të vogël se dyfishi** i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

#### **Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.**

Ngjashmëria e kontratave do të bazohet në natyrën, kompleksitetin dhe/ose karakteristika të tjera të përshkuara në raportin teknik

#### **Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatori/et Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
  1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  2. Kontratën/at e Sipërmarrjes
  3. Situacionin përfundimtar të objektit;
  4. Fatura tatimore përfundimtar te punimeve
  5. Akt kolaudimi;

Formulari i vlerësimit duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, faktin nëse kontrata eshte realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/indokumentacionin e mëposhtëm:
  1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve, shoqëruar me:
  2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
  3. Situacionin përfundimtar të objektit;
  4. Fatura tatimore për situacionin përfundimtar te punimeve.
  5. Akt kolaudimi

## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

*Pika 2.3.1 gërma a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*b) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, sipas modelit të lëshuara nga MTI :*

1. <i>Kategoria</i>	<i>N.P – 1</i>	<i>Niveli i shoqërisë – B</i>
2. <i>Kategoria</i>	<i>N.P – 2</i>	<i>Niveli i shoqërisë – B</i>
3. <i>Kategoria</i>	<i>N.P – 7</i>	<i>Niveli i shoqërisë – A</i>
4. <i>Kategoria</i>	<i>N.P – 10</i>	<i>Niveli i shoqërisë – A</i>
5. <i>Kategoria</i>	<i>N.P – 11</i>	<i>Niveli i shoqërisë – D</i>
6. <i>Kategoria</i>	<i>N.S– 1</i>	<i>Niveli i shoqërisë – A</i>
7. <i>Kategoria</i>	<i>N.S– 8</i>	<i>Niveli i shoqërisë – B</i>
8. <i>Kategoria</i>	<i>N.S– 12</i>	<i>Niveli i shoqërisë – A</i>
9. <i>Kategoria</i>	<i>N.S– 13</i>	<i>Niveli i shoqërisë – B</i>
10. <i>Kategoria</i>	<i>N.S– 14</i>	<i>Niveli i shoqërisë – B</i>
11. <i>Kategoria</i>	<i>NS-18</i>	<i>Niveli i shoqërisë – B</i>

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.*

### **B) Certifikatat që duhet të paraqesi operatori ekonomik:**

*B.1. Operatori ekonomik duhet ta paraqesi certifikate **ISO 9001-2015 (përditësuar)** për Menaxhimin e cilesise se punimeve, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme). (Ak do pranojë edhe certifikata të përditësuar).*

*B.2. Operatori ekonomik duhet te paraqese certificate **ISO14001-2015 (përditësuar)** për menaxhim mjedisi, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme). (Ak do pranojë edhe certifikata të përditësuar).*

*B.3. Operatori ekonomik duhet te paraqese certificate **OHSAS -18001-2007 (përditësuar)** për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) ISO 45001-2018.*

*B.4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 50001 - 2011 (e vlefshme) (përditësuar)** për sistemin e manaxhimit të energjise, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) ISO 50001-2018.*

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

*B.5.Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 27001 - 2013 (e vlefshme) (përditësuar) per sistemim e manaxhimit te sigurise se informacionit objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, Ak do pranojë edhe certifikata të përditësuara).*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se punimeve qe do te marre persiper te realizoje, referuar kontrates se bashkepunimit te nenshkruar.

\*Te gjitha certifikatat e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj duhet te shoqerohen me perkthimin e gjuhes shqipe te noterizuar .*

**C). Per pajisjet e cilesuara si me poshte:**

- Trakti i linjes 110kV (pajisje/materialet pjese e tij).
- Trakti transformatorit dhe monitorim kontrolli ana 20kV (pajisjet/materialet pjese e tij).
- Ana 10 (20)kV dhe sherbimet mbeshtetese (pajisje/materialet pjese e saj).
- SCADA (software/licenca + pajisjet/materialet pjese e saj).

*Operatori ekonomik duhet te paraqese:*

*1 Autorizim te prodhuesit/ve /distributor/eve, per mallrat e ofertuar. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*

*2. Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve e prodhuesit/ve ne gjuhen shqipe per listen e mesiperme, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen. Shenim (Në rastet kur vlerësohen pamundësi të përkthimit të plotë të katalogut nga OE, AK mund të pranojë që OE të paraqesin të perkthyer në gjuhen shqipe vetëm pjesë të katalogut, ku janë përcaktuar të dhënat teknike/specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi).*

*3. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimeve zyrtare te kryera per mallrat e ofertuar, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.*

**D) Per kabllot dhe aksesoret e montimit si me poshte:**

- Kabell XLPE 20kV + Termialet 20 kV
- Kabell/ Percjelles ushqimi AC/DC,
- Kabell kontrolli

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

4. Për kabllin XLPE 20 KV të paraqitet test raport, ku kablli të jetë i testuar sipas standardit **SSH IEC 60502-2**.

5. Terminalet 20kV të paraqitet test raport nga institucione te autorizuar per testim/laboratore testimi.

6.Për kabllin/përcjellesin e ushqimit të paraqiten dokumenta që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet **SSH EN 50575/ SSH IEC 60502**.

**VO:** Te gjitha dokumentat e mesiperme nese nuk jane ne gjuhen shqipe duhet te shoqerohen me perkthimet perkatese dhe noterizim.

D) List pagesat sipas formulareve standarte per sigurimet per 3 (tre) muajt e fundit, ku numri i punonjesve te jete mesatarisht jo me pak se **100** persona.

Per kete dokumentacioni qe duhet te paraqese operatori ekonomik eshte:

- Vertetim nga sigurimet shoqerore apo dega e tatimeve per numrin e te punesuarve dhe qe ju jane paguar detyrimet e kontributet e tyre sipas periudhes se mesiperme.
- Liste pagesat e konfirmuara nga administra tatimore sipas periudhes se mesiperme.

**E) Operatori ekonomik duhet te kete minimum 50 punonjes, te pajisur me kartelat e sigurimit teknik dhe kontratat e punes , per profesionet si me poshte te leshurara nga autoriteti perkates:**

- Elektriciste 20 (njezete)
- Teknik ndertimi 1 (nje)
- Murator 5 (pese)
- Suvatues 5 (pese)
- Bojaxhi 3 (tre)
- Hekurkthyes 3 (tre)
- Karpentier 5 (pese)
- Pllaka shtrues 3 (tre)
- Hidraulik 3 (tre)

F. Operatori Ekonomik ne zbatim te VKM Nr.108 date 09.02.2011 “Per aftesite qe duhet te plotesojne punemarresit, personat dhe sherbimet e specializuara, qe merren me ceshtjet e sigurise dhe te shendetit ne pune“, ndryshuar me VKM Nr.632 date 15.07.2015, duhet te kete te punesuar mjekun e shoqerise ose mjek te kontraktuar nga jashte me kontrate sherbimi, ose kontrate me një subjekt qe operon ne fushen e sherbimeve te tilla mjekesore. Mjeket te jene te pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të



## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotesoje kete kerkese duke pasur ne konsiderate edhe parashikimet e ligjit te cituar me lart.

*- Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij dhe te figurojne si drejtues teknik me licencen e shoqerise dhe ne listepagesat e shoqerise:*

- *2-Inxhinier Elektrik*
- *1-Inxhinier Mekanik*
- *1-Inxhinier Ndertimi*
- *1- Inxhinier Gjeodet*
- *1- Inxhinier Gjeolog*
- *1- Inxhinier Elektronik*
- *1- Inxhiner Hidroteknik*
- *1- Inxhinier Mjediti*

*-Për inxhinierat pjese e stafit te cilet duhet detyrimisht te jene te pasqyruar ne listepagesat e shoqerise, duhet të paraqitet kontratë pune me afat vlefshmerie Brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt si edhe diplomën perkatese.*

*-Përvec inxhinierave si drejtues teknike, në listë pages duhet të rezultojne të punësuar ne borderote perkatese personeli teknik i domosdoshëm ku te perfshihen dhe elektricistet.*

*Operatori Ekonomik ofertues duhet te percaktoje me ane te nje deklarate (Nga Administratori i Shoqerise) Drejtuesin Teknik te punimeve ne objekt (Inxhinier) te perfshire me licensimin e shoqerise dhe te deklarroje se ai do te jete i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryen punimet ne objekt, shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:*

- *Libreze pune (perkatese)*
- *Kontrate pune e vlefshme (perkatese)*

*Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne stafin e tij te siguruar 3 (tre) muaj e fundit te pakten 2 (nje) inxhinier elektrik te kualifikuar per instalimet e paneleve te matjes dhe mbrojtjes dhe konfigurimit te tyre me sallen e komandimit te nenstacionit per mbledhjen e te dhenave dhe supervizimin e tyre ne distance (SCADA). Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese kontraten individuale te punes, e vlefshme per gjithë periudhen e realizimit te objektit, te shoqeruar me certifikaten e trajnimit te inxhinierit, te leshuar nga prodhuesi i sistemit ne fjale (me ane te se ciles, provohet se inxhinieret ne fjale, zoterojne kualifikimet minimale te nevojshme per ndertimi, konfigurimin, testimin dhe venien ne pune te sistemit Scada), si dhe te figuroje dhe listpagesat per 3 (tre) muajt e fundit.*

**2.3.12** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij:

- 1 (një) Ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomën, kontratën individuale të punës (të vlefshme), si dhe certifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

**2.3.13** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij:

- 1 (një) specialiste te sigurimit dhe Shendetit ne pune (HSE)

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë pune të vlefshme, të pajisur me certifikatë/ dëshmi trajnimi të lëshuar nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Operatorët ekonomikë ofertues duhet të ketë të punësuar staf për realizimin e shërbimit sa më poshtë:

- 1 Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa dhe Instalime Industriale.

*G. Makineri pajisje që duhet të disponojë Firma zbatuese e punimeve.*

*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike qeka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik te nevojshme per realizimin e kontrates:*

Nr.	Pershkrimi i Automjetit	Sasia
1.	Mjetkulle me ngjitje vertikale me kosh ne peshe pune 200 kg e lart	1 Cope
2.	Autovinc vetshkarkues mbi 5 ton	1 copë
3.	Vinc mbi ose 90 Ton	1 copë
5.	Megaohmeter 1000 volt	1 copë
6.	Terameter	1 copë
7.	Eskavator me goma	1 copë
8.	Minifadrome	1 copë
10.	Kamion min mbi 7 ton	1 copë
13.	Gjenerator per kantier	1 cope
14.	Matrapik	1 cope
15.	Vibratore betoni	2 cope

Per mjetet qe shenohen ne regjistrat publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) , plus certifikaten e kontrollit teknik , dhe siguracionin e mjetit shoqeruar me fotot perkatese te dallueshme, dhe per mjetet e siguruara me qera,dhe siguracionin e mjetit, (te

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

vlefshme) duhet të shoqerohet me kontraten perkatese te qerase, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt prokurimi shoqeruar me fotot perkatese te dallueshme.

- Operatori duhet te paraqese Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese, qe makineritë e mësipërme nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera por vetem per kete objekt ne rast te shpalljes fitues .(Ne rast se ofertuesi eshte bashkim i operatoreve, cdo anetar i ketij bashkimi duhet te paraqese kete dokument).

-Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese per vendodhjen e mjeteve ne pronesi apo te marra me qira dhe autorizim per verifikimin e tyre nga AK. (Ne rast se ofertuesi eshte bashkim i operatoreve, cdo anetar i ketij bashkimi duhet te paraqese kete dokument).

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar “Apostile”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrtar respektive nga vendi i origjinës.

**2.3.14** Kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”i ndryshuar. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t’i përmbahen VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**2.3.15** Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet te dorezohen marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe Prokura e posaçme. Çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kerkuara, ne perpjestim dhe perputhje me punet e marrra perisiper sipas marrevshjes se bashkepunimit.

**2.3.16.** Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

### **Shtojca 13**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Bashkelidhur DST

Specifikimet Teknike të Materialeve: Bashkelidhur DST

**Shenim: Ne respektim të nenit 23 të LPP –se ne të gjitha rastet kur ne specifikimet teknike permendet “marke” përfshihet termi “ekuivalente”.**

Grafiku i Punimeve:

Afati i realizimit të punimeve **12 (dymbëdhjetë) muaj, nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit nga mbikqyrësi i punimeve.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Bashkelidhur DST**

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

**Shtojca 14**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

Sipas Preventivit Bashkelidhur

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHITËSE**

---

**Shtojca 15**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

**Shtojca 16**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor* ]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues* ]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës* ]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]



**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

**Shtojca 17**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

### **Shtojca 18**

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specififikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndërtimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

### **Neni 9: Komunikimi**

9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

### **Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

### **Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

### **Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

### **Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

### **Neni 15: Ngritja e Kantierit**

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

### **Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezyrtshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

### **Neni 17: Zbulimet**

